

**Vendim nr. 48 datë 11.10.2023**

**(V-48/23)**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimimi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 11.10.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 4 (K) 2023të Regjistrit Themeltar, që u përket:

**KËRKUES:** **KLEANT KESHI (ALIAS GENTIAN HYSA)**

**SUBJEKT I INTERESUAR:**  
**PROKURORIA E PËRGJITHSHME**

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1250(264), datë 13.10.2022 të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 27, 49, pika 3, shkronja “e”, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, propësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari Kleant Keshi (alias Gentian Hysa) është deklaruar fajtor nga gjykatat italiane në tre procese penale, konkretisht: (i) për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”, të parashikuar nga neni 73 i ligjit nr. 309/1990 dhe neni 240 i Kodit Penal (KP) italian, për të cilën është dënuar me 4 vjet e 4 muaj burgim, me gjobë në masën 18.000 euro, si dhe me dënim plotësues “Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike”; (ii) për veprat penale “Dëmtimi” dhe “Kundërshtimi i zyrtarit publik”, të parashikuara nga nenet 337, 582 dhe 576 të KP-së italiane, në rrethana cilësuese, për të cilat është dënuar me 5 muaj burgim; (iii) për veprat penale “Vjedhja”, në rrethana rënduese dhe “Kundërshtimi i zyrtarit publik”, të parashikuara nga nenet 624, 625, paragrafi 7, 337 dhe 99, paragrafi 4, të KP-së italiane, për të cilat është dënuar me 1 vit burgim. Mbi bazën e këtyre vendimeve gjyqësore, Prokurori pranë Gjykatës së Apelit Torino ka nxjerrë urdhrin nr. SIEP 939/2020, datë 15.12.2020, duke përcaktuar ndaj kërkuarit dënimin përfundimtar me 5 vjet e 5 muaj e 27 ditë burgim për të tre dënimet penale të vendosura ndaj tij, për të cilat ka kërkuar arrestimin e përkohshëm, me qëllim ekstradimin dhe, mbi bazën e këtij urdhri, në datën 07.01.2021 kërkuari është shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Roma, Itali.

2. Në datën 13.01.2021 kërkuari është arrestuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibër, ndërsa Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër (*prokuroria*) i ka kërkuar asaj gjykate vleftësimin të ligjshëm të arrestit të përkohshëm, me qëllim ekstradimin e tij në Itali. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. 6, datë 16.01.2021, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë, duke caktuar ndaj kërkuarit masën e sigurisë “Arresti në burg”. Këtë vendim kërkuari e ka kundërshtuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 115, datë 05.02.2021, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë nr. 6, datë 16.01.2021. Kërkuari, më pas, ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër kërkesën me objekt shuarjen/revokimin e masës së sigurisë “Arresti në burg, të caktuar me vendimin nr. 6, datë 16.01.2021 të asaj gjykate, pasi

sipas tij dënimi i mbetur për t'u ekzekutuar ishte tepër i shkurtër. Për atë kërkesë, gjykata e shkallës së parë, me vendimin nr. 27, datë 05.03.2021, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Edhe këtë vendim kërkuesi e ka kundërshtuar me ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

3. Për sa i përket themelit të çështjes, në datën 24.02.2021, prokuroria ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër kërkesën për ekstradimin e kërkuesit nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Italisë. Ajo gjykatë, me vendimin nr. 28, datë 16.03.2021, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë, duke lejuar ekstradimin e kërkuesit për zbatimin e urdhrin nr. SIEP 939/2020, datë 15.12.2020 të Prokurorit pranë Gjykatës së Apelit të Torinos, për të tria çështjet penale për të cilat ishte gjykuar dhe dënuar, pasi nuk ekzistojnë rrethanat që përbëjnë pengesa ligjore të cilat nuk lejojnë ekstradimin dhe, po kështu, kërkesa plotëson kriteret procedurale dhe materiale për këtë qëllim.

4. Kërkuesi në datën 24.03.2021 ka paraqitur ankim kundër vendimit të shkallës së parë në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 258, datë 17.03.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për sa i përket lejimit të ekstradimit për ekzekutimin e vendimit të dënimit të tij për veprat penale “Dëmtimi” dhe “Kundërshtimi i zyrtarit publik” dhe të vendimit për veprat penale “Vjedhja”, në rrethana rënduese dhe “Kundërshtimi i zyrtarit publik”, por e ka ndryshuar atë vendim, duke vendosur refuzimin e ekstradimit të kërkuesit për ekzekutimin e vendimit të dënimit të tij për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”, pasi për këtë të fundit është parashkruar ndjekja penale sipas legjislacionit shqiptar dhe në bazë të parimit të reciprocitetit në marrëdhëniet juridiksionale, kërkuesi nuk mund të ekstradohet.

5. Vendimin nr. 258, datë 17.03.2022 të gjykatës së apelit e kanë kundërshtuar të dyja palët me rekurse në Gjykatën e Lartë, përkatësisht kërkuesi në datën 02.06.2022 dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë në datën 06.06.2022.

6. Ndërkohë, pas dhënies së vendimit nr. 258, datë 17.03.2022, gjykata e apelit ka marrë në shqyrtim edhe ankimin e kërkuesit ndaj vendimit nr. 27, datë 05.03.2021 të gjykatës së shkallës së parë, që kishte rrëzuar kërkesën e tij me objekt: “Shuarje/revokim ose zëvendësim të masës shtrënguese të përkohshme “Arresti në burg”” (*shih paragrafin 2 më sipër*). Me vendimin nr. 278, datë 28.03.2022, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesës, duke zëvendësuar masën “Arresti në burg”, të caktuar me vendimin nr. 6, datë 16.01.2021 të gjykatës së shkallës së parë, me masën “Arresti në shtëpi”, sipas nenit 237 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Në atë

vendim gjykata e apelit ka konkluduar se pas vendimit nr. 258, datë 17.03.2022, nevojat e sigurimit janë zbutur dhe masa “Arresti në burg” nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose të dënimit për të cilin ishte caktuar, për rrjedhojë ajo duhet zëvendësuar me një tjetër më të butë, sikurse ajo e “Arrestit në shtëpi”, të cilën, për rastin konkret, e ka konsideruar si masë proporcionale (*shih paragrafin 3 në faqen 6 dhe paragrafët 2 dhe 4 në faqen 8 të vendimit nr. 278, datë 28.03.2022 të Gjykatës së Apelit Tiranë*).

7. Në vijim, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë e ka kundërshtuar me rekurs në Gjykatën e Lartë edhe vendimin nr. 278, datë 28.03.2022 të gjykatës së apelit, duke kërkuar ndryshimin e atij vendimi dhe rrëzimin e kërkesës së kërkuarit si të pabazuar në ligj, me pretendimin se masa e sigurimit në rastin konkret ishte caktuar nga nevojat për të garantuar dorëzimin e personit, pra për të garantuar rrezikun e ikjes, të cilat nuk kanë ndryshuar. Kërkuar nuk paraqet garanci për respektimin e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”, pasi ai i është shmangur drejtësisë, duke qenë në dijeni të procedurave të ndërmarra ndaj tij nga autoritetet italiane dhe, po kështu, i është shmangur edhe gjykimit, duke mos respektuar masat e sigurimit të vendosura ndaj tij në shtetin italian.

8. Gjatë kohës që të dyja çështjet e mësipërme qëndronin në pritje për t’u shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. 101, datë 21.07.2022, ka vendosur të shpallë moskompetencën për shqyrtimin e kërkesës me objekt: “Shuarjen/revokimin e masës shtrënguese “Arresti në shtëpi” të caktuar me vendimin nr. 278, datë 28.03.2022 të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke i dërguar aktet në Gjykatën e Lartë, pasi ka vlerësuar se nuk ishte kompetente për shqyrtimin e saj. Bazuar në vendimin e gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Lartë, pasi e ka regjistruar si çështje në datën 01.08.2022, me vendimin e datës 13.10.2022, ka vendosur ta bashkojë atë me çështjen e themelit të kërkesës së prokurorisë për lejimin e ekstradimit të kërkuarit, për t’i shqyrtuar bashkë.

9. Fillimisht, Gjykata e Lartë ka shqyrtuar rekursin e paraqitura nga kërkuar dhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për kundërshtimin e vendimit të gjykatës së apelit nr. 258, datë 17.03.2022, që i përket kërkesës së prokurorisë për lejimin e ekstradimit të kërkuarit. Kolegji Penal i asaj gjykate, me vendimin nr. 00-2022-1250 (264), datë 13.10.2022, në dhomën e këshillimit, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 258, datë 17.03.2022 të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 28, datë 16.03.2021 të gjykatës së shkallës së parë.

10. Në vendimin e saj Gjykata e Lartë ka arsyetuar se pretendimet e ngritura në rekursin e kërkuesit nuk janë të bazuara dhe për to ka marrë përgjigje të arsyetuar. Nga ana tjetër, ajo gjykatë ka vlerësuar se rekursi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë përmban shkaqe të parashikuara në nenin 432 të KPP-së, të cilat lidhen me zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykata e apelit, pasi në kushtet kur Republika e Italisë e ka pranuar me rezervë Protokollin e Katërt Shtesë të Konventës Evropiane për Ekstradimin, në ndryshim nga Republika e Shqipërisë, në rastin e ekstradimeve të kërkuara nga shteti italian nuk zbatohet parimi i reciprocitetit, por ai i hierarkisë së akteve.

11. Pas vendimit të mësipërm, Gjykata e Lartë ka shqyrtuar rekursin e paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për kundërshtimin e vendimit të gjykatës së apelit nr. 258, datë 17.03.2022, për sa i përket çështjes për caktimin ndaj kërkuesit të masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”. Kolegji Penal i asaj gjykate, me vendimin nr. 00-2022-1394 (288), datë 03.11.2022, në dhomën e këshillimit, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 278, datë 28.03.2022 të gjykatës së apelit dhe rrëzimin e kërkesës, duke arsyetuar se pas lënies në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për çështjen e themelit të kërkesës së prokurorisë për ekstradimin e kërkuesit, ka rënë edhe shkak ligjor për të cilin ishte vendosur zëvendësimi i masës së sigurimit nga “Arresti në burg” me masën e sigurimit “Arresti në shtëpi” (*shih paragrafin 15 të vendimit nr. 00-2022-1394 (288), datë 03.11.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). Sipas informacionit të Prokurorisë së Përgjithshme, me shkresën nr. 530/3 prot., datë 05.05.2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër në datën 08.11.2022 ka nxjerrë urdhrin për ekzekutimin e vendimit penal të lejimit të ekstradimit, i cili nuk është ekzekutuar për shkak të largimit të kërkuesit nga banesa, duke regjistruar ndaj tij procedimin penal nr. 451, datë 15.11.2022 për veprën penale “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”, të parashikuar nga neni 323 i Kodit Penal (KP).

12. Me kërkesën e datës 13.02.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1250 (264), datë 13.10.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me të cilin ka vendosur lejimin e ekstradimit të tij si të papajtueshëm me Kushtetutën. Kolegji i Gjykatës në datën 27.04.2023, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim

paraparak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 09.05.2023 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

## II

### **Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese**

13. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, në drejtim të:

- 13.1. *Së drejtës për t'u njoftuar për seancën gjyqësore dhe për t'u dëgjuar në proces*, sepse pas depozitimit të rekursit nga sekretaria e Gjykatës së Lartë nuk ka pasur asnjë informacion për trupin shqyrtues, datën e caktuar dhe mënyrën e gjykimit të rekursit (në dhomën e këshillimit apo seancë gjyqësore). Njoftimi për datën dhe mënyrën e shqyrtimit të rekursit nuk është realizuar sipas nenit 436, pika 3, të KPP-së.
- 13.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe së drejtës së aksesit në gjykatë*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka keqinterpretuar nenet 432 dhe 462 të KPP-së. Neni 432 i KPP-së është një dispozitë e përgjithshme që zbatohet për çdo natyrë çështje penale që shkon në Gjykatën e Lartë nëpërmjet rekursit të palëve. Në mënyrë të posaçme ligji ka rregulluar shqyrtimin e çështjeve të ekstradimit, si për sa u përket afateve (shqyrtimi brenda tre muajve në çdo shkallë gjykate), përbërjes së trupës gjyqësore (shqyrtimi nga trup gjyqësor i përbërë nga një gjyqtar në gjykatën e apelit, sipas ndryshimeve të vitit 2021), si dhe marrjes formë të prerë (në Gjykatën e Lartë). Rregullimi i posaçëm prevalon mbi atë të përgjithshmin, në rastet kur gjykata duhet të zgjedhë për zbatim. Në rastin konkret, rregulli procedural penal në nenin 462 të KPP-së, në mënyrë të posaçme për rastet e ekstradimit, ka përcaktuar se vendimi merr formë të prerë në Gjykatën e Lartë dhe kjo e fundit duhet ta shqyrtojë çështjen si një gjykatë ligji e fakti, në të kundërt subjektit i mohohet e drejta e aksesit në një shkallë të gjyqësorit.
- 13.3. *Sigurisë juridike*, pasi neni 438 i KPP-së, në pikën 4 të tij, ka përcaktuar se vendimi i Kolegjit Penal dhe kolegjeve të bashkuara është i detyrueshëm për gjykatat në gjykimin e çështjeve të ngjashme. Kolegji Penal në një çështje të ngjashme me

vendimin 00-2022-1446, datë 20.08.2022 ka mbajtur qëndrim për mënyrën e zbatimit të parimit të reciprocitetit. Qëndrimi i mbajtur me këtë vendim, jo vetëm që zgjidhi çështjen konkrete, por krijoi një praktikë të re, duke vlerësuar se Republika e Shqipërisë do të zbatojë reciprocitetin ndaj shtetit kërkues, Republikës së Italisë. Në më pak se një muaj Gjykata e Lartë mbajti qëndrim të ndryshëm në çështjen e kërkuesit, duke krijuar jo vetëm pasiguri juridike lidhur me trajtimin e rasteve të njëjta, por duke krijuar konfuzion tek gjykatat më të ulëta lidhur me praktikën që duhet zbatuar. Një nga kompetencat e Gjykatës së Lartë është njësimi i praktikës, në rastet kur për të njëjtën çështje ndiqen praktika të ndryshme nga gjykatat më të ulëta, por është e papranueshme që vetë Gjykata e Lartë të ketë qëndrime të ndryshme, për më tepër në distancë kohore shumë të shkurtër dhe të pajustificuar nga nevoja për ndryshim të praktikës.

14. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, ka prapësuar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

- 14.1. Pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektin e së drejtës për t'u njoftuar për seancën gjyqësore dhe për t'u dëgjuar në proces është i pabazuar dhe, si i tillë, nuk duhet të pranohet, pasi të dhënat për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit janë publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në shpalljen e datës 03.10.2022, ndërsa në nenet 436, 436/a dhe 437 të KPP-së, për sa i përket shqyrtimit të çështjeve në dhomën e këshillimit, nuk parashikohet një mënyrë eksplicite për mënyrën e njoftimit të palëve për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit.
- 14.2. Pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe të së drejtës së aksesit në gjykatë është i pabazuar dhe duhet të rrëzohet, pasi kërkuesi, përmes argumentimit të domosdoshmërisë së shqyrtimit të çështjes së tij në seancë gjyqësore, sipas nenit 462 të KPP-së, synon t'u japë kuptim të ndryshëm neneve 432 e vijues të KPP-së, por neni 462 i KPP-së nuk mund të gjejë zbatim më të zgjeruar nga sa ka përcaktuar vetë ligjvënësi. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë ka ushtruar të drejtën e saj ligjore për ta gjykuar çështjen brenda parashikimeve ligjore të gjykimit prej saj. Gjithashtu, ajo gjykatë ka shqyrtuar

çështjen në tërësi, duke kthyer përgjigje ndaj çdo pretendimi të kërkuarit, pa dalë nga natyra e saj si gjykatë e ligjit, pasi edhe në çështjet e ekstradimit ajo vepron si shkallë e tretë e gjyqësorit vetëm për efekt të kontrollit të ligjshmërisë së vendimeve të shkallëve më të ulëta. Për këto arsye, kërkuari nuk ka argumentuar se Gjykata e Lartë nuk është gjykatë e krijuar me ligj dhe që ajo nuk ka funksionuar si e tillë.

- 14.3. Pretendimi për cenimin e sigurisë juridike është i pabazuar dhe duhet të rrëzohet, pasi për çështjen tjetër së cilës i referohet kërkuari për të evidentuar qëndrimin e ndryshëm të Gjykatës së Lartë, vendimi është i një trupi gjyqësor me 3 gjyqtarë në Kolegjin Penal të asaj gjykate dhe jo i një Kolegji Penal me 5 gjyqtarë në kuptim të nenit 438 të KPP-së. Për rrjedhojë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin e çështjes tjetër nuk ka njëzuar ose zhvilluar praktikë gjyqësore të detyrueshme.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### A. Për legjitimitimin e kërkuarit

15. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

16. Gjykata çmon se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ku është dhënë vendimi i kundërshtuar, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar.

17. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ankuesi duhet të shfrytëzojë në shkallët



e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 7, datë 21.02.2023; nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 56, datë 25.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin konkret, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pas zhvillimit të gjykimit në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm, duke shteruar kështu mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Pretendimet që ai parashtron në substancë në këtë ankim lidhen me procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për rrjedhojë ai nuk ka në dispozicion ndonjë mjet tjetër ankimi përveç ankimit kushtetues individual.

19. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata vëren se procesi gjyqësor ka përfunduar me vendimin e datës 13.10.2022 të Gjykatës së Lartë, i cili është komunikuar në datën 02.12.2022, në mënyrë elektronike, në adresën e avokatit të kërkuesit, në përputhje me nenin 436, pika 3, të KPP-së. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se momenti i konstatimit të cenimit të të drejtave kushtetuese, nga i cili fillon të rrjedhë afati i paraqitjes së ankimit kushtetues, konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar është bërë efektivisht i disponueshëm për kërkuesin dhe ai është njohur me shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen e kundërshtuar të asaj gjykate, pra data 02.12.2022. Gjykata vëren se ankim i kushtetues individual është paraqitur në datën 13.02.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor, për rrjedhojë kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*.

20. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe së drejtës së aksesit në gjykatë, me argumentin se Gjykata e Lartë për çështjet e ekstradimit duhet të gjykojë edhe si një gjykatë fakti, në referim të nenit 462 të KPP-së. Gjykata konstaton se në thelb pretendimet e kërkuesit lidhen me procedurat e ekstradimit të tij jashtë territorit të Shqipërisë. Gjykata në jurisprudencën e saj ka evidentuar se në përputhje me nenin 39, pika 2, të Kushtetutës, ekstradimi lejohet kur parashikohet shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare dhe vetëm me vendim gjyqësor. Togfjalëshi “*vetëm me vendim gjyqësor*” do të thotë se lejimi i ekstradimit vlerësohet përmes një procesi gjyqësor, i cili në këto raste duhet të përmbushë standardet e procesit të rregullt ligjor, të parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës dhe të

materializuara në jurisprudencën kushtetuese (*shih vendimin nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kontekst, për t'u dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuarit, Gjykata do të analizojë nëse procesi gjyqësor për ekstradimin ka qenë i rregullt në aspektet e ngritura prej tij.

21. Në këtë këndvështrim, lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, Gjykata vëren se Kushtetuta nuk bën dallim në sferën e kompetencave të Gjykatës së Lartë midis procesit për ekstradim dhe proceseve të tjera gjyqësore. Edhe neni 462 i KPP-së, të cilit i referohet kërkuari në pretendimin e tij, nuk rregullon formën e gjykimit penal, por kohën se kur ekzekutohet vendimi penal për ekstradimin. Në këto kushte, Gjykata e Lartë edhe në procedurat e ekstradimit nuk e shqyrton çështjen si gjykatat e faktit, por kryen funksionin e saj kushtetues si gjykatë e ligjit. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është haptazi i pabazuar.

22. Për sa u përket pretendimeve për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës për t'u njoftuar për seancën gjyqësore dhe për t'u dëgjuar në proces, si dhe për cenimin e sigurisë juridike, Gjykata çmon se hyjnë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të shqyrtojë në vijim bazueshmërinë e tyre në themel.

## *B. Për themelin e pretendimeve*

### *B.1. Për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar për seancën gjyqësore dhe për t'u dëgjuar në proces*

23. Kërkuari ka pretenduar se pas depozitimit të rekursit nga sekretaria e Gjykatës së Lartë nuk ka pasur asnjë informacion për trupin shqyrtues, datën e caktuar dhe mënyrën e gjykimit të rekursit (në dhomën e këshillimit apo seancë gjyqësore). Të tria këto informacione përbëjnë detyrim për njoftim, në funksion të një procesi të rregullt ligjor. Njoftimi për datën dhe mënyrën e shqyrtimit të rekursit, gjithashtu, është detyrim i parashikuar nga neni 436, pika 3, i KPP-së, që sanksionon: "Sekretaria e gjykatës njofton palët nëpërmjet afishimit në këndin e njoftimeve dhe faqen elektronike zyrtare për datën dhe orën e gjykimit të paktën 30 ditë përpara. Kur palët kanë adresë elektronike të deklaruar apo të njohura, sekretaria kryen njoftimin edhe në këto adresë." Adresa elektronike ishte e deklaruar në çdo faqe të rekursit dhe njëkohësisht e njohur nga sekretaria e Gjykatës së Lartë për aq kohë që vazhdimisht për palë të tjera ka pasur komunikim. Gjithashtu nuk rezulton të jetë përmbushur edhe njoftimi nëpërmjet afishimit ose faqes elektronike të

Gjykatës. Megjithëse në shqyrtimin e rekurseve Gjykata e Lartë përgjithësisht procedon me shqyrtimin jo në seancë publike me praninë e palëve, por në dhomën e këshillimit mbi bazën e dokumenteve të paraqitura, kjo nuk nënkupton se ky lloj gjykimi përjashton detyrimin për njoftimin e rregullt të palëve, duke shmangur garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se neni 436/3 i KPP-së është dispozitë urdhëruese dhe e detyrueshme për zbatim në çdo rast. Interpretimi i kundërt lë shteg për arbitraritet dhe mundësinë e zbatimit të kësaj dispozite vetëm kur Gjykata e Lartë çmon se mosnjoftimi e bën procesin të parregullt e që në njëfarë mënyre përbën paragjykim të çështjes dhe pabarazi. Zbatimi i kësaj dispozite nuk mund të jetë selektiv në bazë të pasojës që i sjell të interesuarit. Pavarësisht se njoftimi i palëve për datën, orën dhe mënyrën e shqyrtimit të rekursit duhet të realizohet në çdo çështje që shqyrtohet nga Gjykata e Lartë, në çështjet e ekstradimit merr rëndësi të veçantë.

24. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se të dhënat për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit janë publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në shpalljen e datës 03.10.2022, ndërsa në nenet 436, 436/a dhe 437 të KPP-së, për sa i përket shqyrtimit të çështjeve në dhomën e këshillimit, nuk parashikohet një mënyrë eksplicite për mënyrën e njoftimit të palëve për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit.

25. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

26. Në jurisprudencën kushtetuese Gjykata ka evidentuar rëndësinë e së drejtës për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim, e cila u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Gjithashtu, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 49, datë 22.07.2016; nr. 21, datë 04.04.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i takon procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, kjo e

fundit, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike ose mbi bazë dokumentesh, duhet t'u garantojë palëve të drejtën që jo vetëm të njihen në kohë me pretendimet e palës tjetër, por edhe të kenë mundësinë që t'i kundërshtojnë ato apo të paraqesin argumentet e tyre për çështjen. Ajo ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimet nr. 41, datë 18.09.2023; nr. 13, datë 12.03.2023; 17, datë 01.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Fillimisht, Gjykata vlerëson të theksojë se parametrat kushtetues që garantojnë të drejtën për proces të rregullt ligjor, në radhë të parë, duhet të parashikohen nga legjislacioni procedural dhe, më pas, sipas rastit, duhet të përmbushen nga organet e pushtetit publik, përfshirë gjykatat nëpërmjet zbatimit të dispozitave ligjore procedurale. Në këtë këndvështrim, kur ankimi kushtetues individual ka në objektin e tij mënyrën se si kanë vepruar këto organe, atëherë kontrolli kushtetues ushtrohet për të verifikuar nëse organi i pushtetit publik ka përmbushur detyrimet ligjore në atë masë që të jetë respektuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt ligjor.

28. Gjykata vëren se procedura e ekstradimit të një shtetasi shqiptar është e lidhur me të drejtën kushtetuese të mosdëbimit nga territori, prandaj Kushtetuta në nenin 39, pika 2, parashikon se “2. Ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, dhe vetëm me vendim gjyqësor”. Për këtë shkak merr rëndësi që procesi gjyqësor, përfshirë njoftimin e palëve, të jetë i rregullt dhe në përputhje me parashikimet ligjore. Ashtu siç parashtron subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, KPP-ja nuk parashikon rregulla të posaçme për njoftimin e palëve për Gjykatën e Lartë për seancën që zhvillohet në dhomën e këshillimit dhe për seancën që zhvillohet për çështjet e ekstradimit, ndaj janë të zbatueshme rregullat e përgjithshme të nenit 436, pika 3, të KPP-së. Ky i fundit parashikon se sekretaria e Gjykatës së Lartë ka detyrim ligjor: (i) të njoftojë palët nëpërmjet afishimit në këndin e njoftimeve dhe faqen elektronike zyrtare për datën dhe orën e gjykimit të paktën 30 ditë përpara; (ii) kur palët kanë adresa elektronike të deklaruara ose të njohura, sekretaria duhet të kryejë njoftimin edhe në këto adresa. Po kështu, zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë ka nxjerrë urdhrin administrativ nr. 131, datë 02.07.2021 “Për publikimin e datave të gjykimeve dhe njoftimin e palëve” (*urdhri administrativ nr. 131/2021*), në pikën 5 të të cilit parashikohet se kur

sekretaria gjyqësore konstaton se palët kanë deklaruar si të dhënë kontakti adresën e postës elektronike (*e-mail*), duhet të bëjë edhe njoftimin elektronik për datën e gjykimit.

29. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë në datën 03.10.2022 ka shpallur në faqen e saj zyrtare listën e çështjeve të planifikuara për shqyrtim në dhomën e këshillimit nga Kolegji Penal në datën 13.10.2022, mes të cilave edhe dy çështjet e kërkuarit, atë që është objekt i ankimit kushtetues, si dhe çështjen tjetër të regjistruar në bazë të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër të datës 21.07.2022 për deklarimin e moskompetencës së saj për shqyrtimin e kërkesës me objekt shuarjen/revokimin e masës shtrënguese “Arrestimi në shtëpi”. Ndërkohë, njoftimi nuk rezulton të jetë kryer me *e-mail* në adresën elektronike të avokatit të kërkuarit, ndonëse ai e kishte depozituar atë. Në atë ditë, me vendimin nr. 00-2022-1250 (264), datë 13.10.2022, Kolegji Penal i asaj gjykate, në dhomën e këshillimit, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 258, datë 17.03.2022 të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 28, datë 16.03.2021 të gjykatës së shkallës së parë. Vendimi përfundimtar në datën 02.12.2022 është njoftuar në adresën elektronike të avokatit të kërkuarit, çka tregon se sekretaria e Gjykatës së Lartë ishte në dijeni se mbrojtësi kishte depozituar këtë adresë elektronike.

30. Për sa më lart, Gjykata konstaton se pavarësisht se avokati i kërkuarit ka depozituar të dhënat elektronike, ai nuk është njoftuar nëpërmjet *e-mail*-it për datën e seancës. Gjithashtu, Gjykata e Lartë, duke publikuar datën e zhvillimit të seancës vetëm 10 ditë para, nuk ka respektuar afatin 30-ditor të parashikuar nga neni 436, pika 3, i KPP-së për publikimin e datës së seancës në faqen zyrtare, si dhe nuk ka dhënë arsyet e shkurtimit të afatit. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ka pasur shkelje të së drejtës së njoftimit e për rrjedhojë edhe të së drejtës së kërkuarit për t’u dëgjuar.

31. Për sa u takon shkeljeve të rregullave procedurale, Gjykata çmon të ritheksojë qëndrimin e mbajtur edhe më parë prej saj, se jo çdo shkelje e bën procesin të parregullt, në aspektin e cenimit të të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 71, datë 13.11.2017; nr. 30, datë 19.05.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata ka vlerësuar se gjatë shqyrtimit të pretendimeve për të drejtën për proces të rregullt ligjor nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes procedurale, por duhet të analizohet

karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuesin dhe për interesat që ai përfaqëson (*shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Prandaj, në vijim, Gjykata, në kontekstin e rrethanave të çështjes, do të analizojë nëse shkelja ka qenë thelbësore.

32. Gjykata vlerëson se ekstradimi është një proces që gëzon mbrojtje dhe garanci të posaçme ligjore dhe duke qenë se ai është i lidhur me marrëdhëniet juridiksionale mes shteteve, normat procedurale penale parashikojnë procedura dhe afate ligjore më të shpejta për zhvillimin e procesit se sa për proceset e tjera të parashikuara nga legjislacioni shqiptar. Prioriteti me të cilin duhen shqyrtuar çështjet e ekstradimit, gjithsesi, nuk do të thotë se nuk duhet të respektohen rregullat procedurale në përgjithësi, duke përfshirë edhe ato për njoftimin e palëve. Kjo do të thotë se gjykatat duhet të sigurojnë procesin e rregullt ligjor, pra që të veprojnë brenda afateve të shpejta, të cilat njëkohësisht duhet të jenë edhe të arsyeshme, në kuptimin që individët të kenë mundësinë e duhur për të ushtruar rregullisht të drejtat dhe garancitë e tyre. Prandaj, në vlerësimin e Gjykatës, njoftimi në kohën e duhur për zhvillimin e procesit gjyqësor të lidhur me ekstradimin përbën një garanci e domosdoshme për pjesëmarrjen e individit në procesin gjyqësor.

33. Në çështjen konkrete, Gjykata e Lartë është prirur nga shpejtësia në gjykimin e çështjes, duke e marrë në shqyrtim me prioritet në raport me çështjet e tjera të regjistruara, si dhe duke shkurtuar afatin ligjor të njoftimit me 20 ditë, pa dhënë arsye për këtë shkurtim dhe në rrethanat që as palët nuk kanë dhënë pëlqimin e tyre në drejtim të shkurtimit të tij. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se mosrespektimi i afateve të publikimit të datës së seancës në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, si dhe mosnjoftimi nga ana e sekretarisë së kësaj gjykate të datës së seancës në adresën elektronike të depozituar nga avokati i kërkuesit, në rastin konkret përbëjnë shkelje me natyrë thelbësore, vërtetimi i të cilave ka shkaktuar pamundësinë e kërkuesit për të marrë pjesë në gjykim. Me fjalë të tjera, këto shkelje procedurale të konstatuara kanë karakter të tillë që kanë passjellë kufizimin e së drejtës për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe të parimit të barazisë së armëve në gjykim për kërkuesin, gjykim i cili kishte interes të lartë për kërkuesin, pasi lidhej drejtpërdrejt me kufizimin e së drejtës kushtetuese për të mos u dëbuar nga territori, përveçse me anë të ekstradimit.

34. Bazuar në këto premisa, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, në funksionin e saj si gjykatë e ligjit, duhej të kishte respektuar rregullat e njoftimit të parashikuara nga neni 436 i KPP-së, në drejtim të njoftimit elektronik dhe afatit 30-ditor, për t'u dhënë palëve mundësinë të ushtronin të drejtën e tyre të mbrojtjes me cilësi dhe efektivitet, aq më tepër kur në rastin konkret

duhej pasur në konsideratë fakti se vendimet e dhëna nga dy gjykatat e shkallëve më të ulëta janë diametralisht të kundërta me njëra-tjetrën dhe gjykata e apelit kishte dhënë vendim të favorshëm për kërkuesin.

35. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se shkeljet e konstatuara kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, duke e bërë atë proces të parregullt në kuptimin kushtetues, ndaj pretendimi i kërkuesit është i bazuar.

36. Për sa i takon pretendimit tjetër të kërkuesit, që ka të bëjë me cenimin e parimit të sigurisë juridike, Gjykata vlerëson të mos ndalet në analizimin e tij, për sa kohë çështja do të merret përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, e cila në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit duhet t'i japë përgjigje të arsyetuar këtij pretendimi.

37. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit janë pjesërisht të bazuara dhe kërkesa duhet të pranohet sipas arsyetimit të mësipërm.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

### **V E N D O S I:**

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1250 (264), datë 13.10.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**Marrë më 11.10.2023**

**Shpallur më 13.11.2023**

## MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e ankimit kushtetues individual të paraqitur nga kërkuesi Kleant Keshi (alias Gentian Hysa), me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1250(264), datë 13.10.2022 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ne gjyqtarët në pakicë kemi votuar për rrëzimin e kërkesës. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur për shfuqizimin e vendimit gjyqësor të kundërshtuar dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, vlerësojmë të shprehemi me mendim pakice.

2. Në ankimin e tij kushtetues individual kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar se Gjykata e Lartë i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në aspektin e së drejtës për t'u njoftuar për seancën gjyqësore dhe asaj për t'u dëgjuar në proces. Lidhur me këtë pretendim, ai ka argumentuar se nga gjykata nuk ka pasur asnjë informacion për trupin gjykues, datën e caktuar dhe mënyrën e gjykimit të rekursit (në dhomë këshillimi apo në seancë gjyqësore), informacione këto që përbëjnë detyrim për njoftim në funksion të procesit të rregullt, përveçse një detyrim i tillë parashikohet edhe në nenin 436, pika 3, të KPP-së. Referuar kësaj dispozite urdhëruese dhe të detyrueshme për zbatim në çdo rast, gjykata nuk ka bërë njoftim në adresën elektronike të mbrojtësit të kërkuesit, adresë e cila është shënuar në çdo faqe të rekursit, përveçse është e njohur për sekretarinë gjyqësore nga komunikimet në çështje të tjera gjyqësore. Po ashtu, gjykata nuk ka bërë as njoftimin nëpërmjet afishimit apo faqes elektronike të saj. Megjithëse në shqyrtimin e rekurseve Gjykata e Lartë, përgjithësisht, procedon me shqyrtimin jo në seancë publike me praninë e palëve, por në dhomën e këshillimit mbi bazën e dokumenteve të paraqitura, kjo nuk nënkupton se ky lloj gjykimi përjashton detyrimin për njoftimin e rregullt të palëve, duke shmangur garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme. Interpretimi i kundërt lë shteg për arbitraritet dhe mundësinë e zbatimit të kësaj dispozite vetëm kur Gjykata e Lartë çmon se mosnjoftimi e bën procesin të parregullt e që në njëfarë mënyre përbën paragjykim të çështjes dhe pabarazi. Njoftimi i palëve për datën, orën dhe mënyrën e shqyrtimit të rekursit në çështjet e ekstradimit merr rëndësi të veçantë, pasi në një proces të tillë Gjykata e Lartë nuk është vetëm një gjykatë ligji, por, referuar nenit 462, pika 3, të KPP-së, ajo vepron si shkalla e tretë e gjykimit, pas së cilës merr vendimi formë të prerë, e si e tillë duhet të ndjekë të njëjtën mënyrë



njoftimi dhe zhvillimi të seancës si dy shkallët e tjera të gjyqësorit, duke e shqyrtuar rekursin domosdoshmërisht në themel, me njoftimin dhe praninë e palëve në seancë gjyqësore. Për më tepër, sipas tij, vendimi objekt ankimi i ka rënduar pozitën, duke lejuar ekstradimin edhe për dënime të parashkruara, në ndryshim nga vendimmarrja e gjykatës së apelit. Përbushja e detyrimit për njoftim nga Gjykata e Lartë, më së paku, do t'i mundësonte atij të kërkonte shqyrtimin e rekursit në seancë gjyqësore në prani të palëve, e në eventualitet të mospranimit të kësaj kërkesë, do të vlerësohej objektiviteti i trupit gjykues në shqyrtimin e rastit.

3. Pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar për seancën gjyqësore dhe asaj për t'u dëgjuar në proces kërkuesi e ka argumentuar me mungesën e njoftimit për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata e Lartë, në mospërbushje të detyrimit që rezulton nga: (i) neni 463, pika 3, i KPP-së, (ii) forma e gjykimit që neni 462, pika 3, i KPP-së përcakton për Gjykatën e Lartë në një proces ekstradimi. Si rezultat i mospërbushjes së këtij detyrimi nga Gjykata e Lartë, sipas kërkuesit, më së paku, atij i është pamundësuar të kërkojë shqyrtimin e rekursit në seancë gjyqësore dhe, në eventualitet të mospranimit të kësaj kërkesë, të vlerësojë objektivitetin e trupit gjykues në shqyrtimin e rastit të tij.

4. Argumentin për formën e gjykimit nga Gjykata e Lartë në një proces ekstradimi, kërkuesi e ka parashtruar edhe në funksion të pretendimit tjetër të tij, atij për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe së drejtës së aksesit në gjykatë. Ky pretendim u vlerësua nga Gjykata si haptazi i pabazuar, në kushtet kur Kushtetuta nuk bën dallim në sferën e kompetencave të Gjykatës së Lartë midis procesit për ekstradim dhe proceseve të tjera gjyqësore, ndërkohë që neni 462 i KPP-së nuk rregullon formën e gjykimit penal, por kohën se kur ekzekutohet vendimi penal për ekstradimin, ndaj edhe në procedurat e ekstradimit Gjykata e Lartë nuk e shqyrton çështjen si gjykatë fakti, por kryen funksionin e saj kushtetues si gjykatë e ligjit (*shih paragrafin 21 të vendimit*). Për rrjedhojë, mbi të njëjtin arsyetim, edhe pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar për seancën gjyqësore dhe asaj për t'u dëgjuar në proces, i mbështetur në argumentin mbi formën e gjykimit nga Gjykata e Lartë, është i pabazuar.

5. Sikurse u parashtrua, pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar për seancën gjyqësore dhe asaj për t'u dëgjuar në proces kërkuesi e mbështet edhe në argumentin e mungesës së njoftimit për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata e Lartë, konkretisht në mosnjoftimin e trupit gjykues, të datës dhe të mënyrës së shqyrtimit të rekursit (në dhomën e këshillimit apo në seancë

gjyqësore), çka, sipas tij, është në mospërbushje të detyrimit sipas nenit 463, pika 3, të KPP-së. Ai ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka bërë njoftim për shqyrtimin e çështjes as në adresën elektronike të mbrojtësit të tij dhe as nëpërmjet afishimit apo faqes elektronike të saj. Një shkelje e tillë, sipas kërkuesit, më së paku, i ka hequr mundësinë për të kërkuar shqyrtimin e rekursit në seancë gjyqësore dhe, në eventualitet të mospranimit të kësaj kërkesë, për të vlerësuar objektivitetin e trupit gjykues në shqyrtimin e rastit.

6. Mbështetur në këtë argument, shumica e ka vlerësuar të bazuar pretendimin e kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar për seancën gjyqësore dhe asaj për t'u dëgjuar në proces. Ajo ka vërejtur se Gjykata e Lartë, në faqen e saj zyrtare, në datën 03.10.2022, ka publikuar njoftimin për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit të datës 13.10.2022. Nga ana tjetër, ky njoftim nuk është bërë në adresën elektronike të avokatit të kërkuesit, ndonëse ai e kishte depozituar atë. Çështja është shqyrtuar në datën e planifikuar dhe vendimi përfundimtar, në datën 02.12.2022, i është njoftuar avokatit të kërkuesit në adresën elektronike, çka tregon se sekretaria e Gjykatës së Lartë ishte në dijeni se mbrojtësi kishte depozituar këtë adresë elektronike (*shih paragrafin 29 të vendimit*). Referuar këtyre të dhënave, shumica ka konstatuar se, pavarësisht se avokati i kërkuesit ka depozituar të dhënat elektronike, ai nuk është njoftuar nëpërmjet *e-mail*-it për datën e seancës. Gjithashtu, Gjykata e Lartë duke publikuar datën e zhvillimit të seancës vetëm 10 ditë para, nuk ka respektuar afatin 30-ditor të parashikuar nga neni 436, pika 3, i KPP-së, për publikimin e datës së seancës në faqen zyrtare, si dhe nuk ka dhënë arsytet e shkurtimit të afatit. Mbi këtë bazë, shumica ka vlerësuar se ka pasur shkelje të së drejtës së njoftimit e për rrjedhojë edhe të së drejtës së kërkuesit për t'u dëgjuar (*shih paragrafin 30 të vendimit*).

7. Për sa i përket karakterit të shkeljes procedurale të konstatuar dhe pasojave të ardhura për kërkuesin dhe për interesat që ai përfaqëson, shumica ka çmuar se mosrespektimi i afateve të publikimit të datës së seancës në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, si dhe mosnjoftimi nga ana e sekretarisë së kësaj gjykate të datës së seancës në adresën elektronike të depozituar nga avokati i kërkuesit, përbëjnë shkelje me natyrë thelbësore, vërtetimi i të cilave ka shkaktuar pamundësinë e kërkuesit për të marrë pjesë në gjykim, duke passjellë për të kufizimin e së drejtës për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe të parimit të barazisë së armëve në gjykim, gjykim i cili kishte interes të lartë për kërkuesin, pasi lidhej drejtpërdrejt me kufizimin e së drejtës kushtetuese për të mos u dëbuar nga territori, përveçse me anë të ekstradimit. Për më tepër, Gjykata e Lartë duhet të kishte

respektuar rregullat e njoftimit në rastin konkret, duke pasur në konsideratë faktin se vendimet e dhëna nga dy gjykatat e shkallëve më të ulëta janë diametralisht të kundërta dhe se gjykata e apelit kishte dhënë vendim të favorshëm për kërkuesin. Mbi këtë bazë, shumica ka vlerësuar se shkelja procedurale e konstatuar ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, duke e bërë atë proces të parregullt në kuptimin kushtetues (*shih paragrafët 33-35 të vendimit*).

8. Në vlerësimin tonë, argumentet e përdorura nga shumica nuk janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se procesi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë është i parregullt në kuptimin kushtetues. Së pari, për sa i përket njoftimit të palëve për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, pra në seancë gjyqësore jo në prani të palëve, por mbi bazë të dokumenteve, nuk mund të thuhet se ky njoftim mungon. Është e vërtetë se nuk është bërë njoftimi elektronik për datën dhe orën e gjykimit për avokatin e kërkuesit, por, nga ana tjetër, është bërë njoftim sipas mënyrë kryesore që neni 463, pika 3, i KPP-së përcakton, pra nëpërmjet afishimit të tij në këndin e njoftimeve dhe në faqen elektronike zyrtare të Gjykatës së Lartë. Po ashtu, njoftimi nuk është bërë të paktën 30 ditë përpara datës së gjykimit, por vetëm 10 ditë përpara, pavarësisht se kërkuesi nuk ka ngritur pretendime për këtë aspekt. Gjithsesi, në këtë drejtim vlen të mbahet në konsideratë se kërkuesi ka qenë në dijeni të procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, për sa kohë ai ka paraqitur rekurs, përveçse është njohur edhe me rekursin e prokurorit, sikundër po ashtu ka qenë i vetëdijshëm se për shkak të parashikimeve ligjore, por edhe të praktikës së Gjykatës së Lartë, procesi potencialisht do të zhvillohej në një kohë të shpejtë, referuar natyrës së tij dhe qenies së kërkuesit nën masën shtrënguese të arrestit. Së dyti, për sa i përket ndikimit që këto parregullsi në njoftimin e seancës gjyqësore në dhomën e këshillimit kanë pasur në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë në aspektin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u dëgjuar, ndryshe nga shumica, vlerësojmë se parregullsitë në njoftim nuk i kanë cenuar dhe as mund t'i cenonin kërkuesit këtë të drejtë. Ligji procedural penal parashikon për palët të drejtën e rekursit ose të kundërrekursit, si dhe shqyrtimin e çështjes nga Gjykata e Lartë, si rregull, në dhomën e këshillimit, bazuar në pretendimet dhe shkaqet e ngritura në rekurs, si dhe prapësimet e paraqitura në kundërrekurs (neni 436/a i KPP-së). Në rastin konkret, kërkuesi ka ushtruar të drejtën e rekursit dhe ka zgjedhur të mos paraqesë kundërrekurs ndaj rekursit të prokurorit. Ndërkohë, ky ligj (KPP-ja) nuk parashikon si mundësi dhe aq më tepër si të drejtë të

palëve, paraqitjen nga ato të parashtrimeve rreth rekursit ose kundërrekursit përpara shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore në dhomën e këshillimit nga Gjykata e Lartë. Gjithsesi, kjo mund të mos pengojë paraqitjen e parashtrimeve të tilla, por një gjë e tillë nuk mund të interpretohet si e drejtë procedurale e palëve dhe, mbi këtë bazë, ngritjen nga ato të pretendimeve në drejtim të së drejtës për t'u dëgjuar. Një gjë e tillë e pranuar nga shumica nuk është pretenduar as nga vetë kërkuesi. Në këtë kuptim, vlerësojmë se kërkuesi nuk i është cenuar e drejta për t'u dëgjuar, për sa kohë ai ka ushtruar të drejtën e rekursit dhe rekursi i tij është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë.

9. Të drejtën për t'u dëgjuar kërkuesi në fakt e ka lidhur me formën e gjykimit në Gjykatën e Lartë, që sipas tij duhet të gjykonte çështjen në seancë gjyqësore në prani të palëve, pretendim që më të drejtë nuk është konsideruar as nga shumica. Po ashtu, ai ka pretenduar se nëse do të ishte njoftuar sipas ligjit, do të kishte paraqitur kërkesë për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në prani të palëve dhe në varësi të vendimmarrjes së trupit gjykues do të vlerësonte objektivitetin e saj në shqyrtimin e rastit. Thënë këtë, duket sikur kërkuesi pretendon se i është cenuar e drejta e aksesit lidhur me paraqitjen e kërkesave procedurale dhe në këtë kuadër edhe e drejta për të kërkuar përjashtimin e trupit gjykues. Forma e gjykimit në Gjykatën e Lartë është e përcaktuar nga ligji procedural penal, si rregull, në dhomën e këshillimit dhe, kur gjykata vlerëson, në seancë gjyqësore në prani të palëve (neni 437 i KPP-së). Në këtë kuptim, sa kohë ligji procedural penal nuk ka kufizime në kohë për paraqitjen e kërkesave nga palët, kërkuesi ka pasur mundësi të paraqiste një kërkesë të tillë bashkë me rekursin ose në periudhën në vijim, pa qenë i kondicionuar nga njoftimi për shqyrtimin e çështjes. Nga ana tjetër, shqyrtimi në seancë gjyqësore në prani të palëve është një çështje që i përket vlerësimit të gjykatës në raport me rastet që ligji ka përcaktuar, pra kur ajo vlerëson se çështja paraqet rëndësi nga pikëpamja e së drejtës për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore ose kur thirrja dhe dëgjimi i palëve vlerësohet prej saj si e nevojshme për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes në rastet e përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 432 të KPP-së. Për rrjedhojë, është i papranueshëm pretendimi hipotetik i kërkuetit lidhur me ushtrimin e së drejtës për të kërkuar përjashtimin e trupit gjykues në hipotezën e refuzimit të kërkesës për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në prani të palëve. Përtej kësaj, vendimet e ndërmjetme të gjykatës në funksion të administrimit dhe mbarëvajtjes të procesit gjyqësor, parimisht, nuk mund të përbëjnë shkak për të vënë në dyshim paanësinë e gjykatës. Nga ana tjetër, kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë argument konkret në drejtim të mungesës së

elementeve subjektive dhe objektive për gjyqtarët e çështjes, elemente të cilat qëndrojnë në themel të parimit të paanshmërisë së gjykatës, në funksion të krijimit të besimit në dhënien e drejtësisë.

10. Për sa më lart, vlerësojmë se shumica, pavarësisht se ka evidentuar, nuk i është përmbajtur jurisprudencës së Gjykatës në drejtim të shkeljeve që e bëjnë procesin të parregullt në kuptimin kushtetues. Ashtu sikundër Gjykata ka theksuar, jo çdo shkelje e bën procesin të parregullt, në aspektin e cenimit të të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 71, datë 13.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për të drejtën për proces të rregullt nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes procedurale, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuesin dhe për interesat që ai përfaqëson (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çdo çështje të veçantë, duke pasur parasysh edhe të gjithë procedurën që mund të jetë ndjekur, Gjykata vlerëson nëse një kufizim ose shkelje gjatë kësaj procedure ka ndikuar drejtpërdrejt në zgjidhjen e çështjes dhe ia ka bërë palës të pamundur mbrojtjen dhe zhvillimin e procesit gjyqësor në mënyrë të drejtë (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 7, datë 28.02.2000 të Gjykatës Kushtetuese*). Në vështrim të standardeve kushtetuese, në rastin konkret, mangësitë në njoftimin e seancës gjyqësore në dhomën e këshillimit nuk mund të konsiderohen si shkelje thelbësore që e bëjnë të parregullt, në kuptimin kushtetues, procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për sa kohë nuk kanë pasur ndikim në të drejtën për t'u dëgjuar të kërkuesit. Rëndësia e së drejtës themelore për mbrojtjen nga ekstradimi, që ka qenë pjesë e procesit gjyqësor, nuk mund të shërbejë si argument për shtuar shkallën e shkeljes procedurale dhe, aq më tepër, për të konsideruar ndikimin e saj në proces dhe ardhjen e një pasoje inekzistente në aspektin e procesit të rregullt ligjor. Po ashtu, nuk mund të shërbejë për këtë qëllim as argumenti i kërkuesit, i pranuar nga shumica, lidhur me mënyrën e zgjidhjes së çështjes nga Gjykata e Lartë, në disfavorin e tij. Është e qartë se një vendim gjyqësor në favor të individit do të passillte për të mungesën e interesit për ngritjen e pretendimeve kushtetuese në drejtim të procesit të rregullt ligjor, ndërkohë që e kundërta thjesht tregon pasjen nga ai të një interesi kushtetues për kundërshtimin e procesit gjyqësor, por pasja e një interesi të tillë nuk mund të provojë *apriori* cenimin e së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor dhe as karakterin dhe pasojat e këtij cenimi.

11. Në përfundim, në kuptim të normave kushtetuese, standardeve jurisprudenciale të kësaj Gjykate dhe fakteve të natyrës kushtetuese, vlerësojmë se pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u njoftuar për seancën gjyqësore dhe asaj për t'u dëgjuar në proces nuk është i bazuar. Për rrjedhojë, për sa kohë cenimi i kësaj të drejte ka përbërë shkak për shumicën për pranimin e kërkesës, vlerësojmë se kërkesa për këtë shkak duhet të rrëzohej.

**Kryetare: Holta Zaçaj**

**Anëtarë: Elsa Toska, Ilir Toska, Genti Ibrahim**